

„DP & PARTNERS ” Sh.p.k.

RAPORT
I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR BAZËN E PRODHIMIT TË BETONIT NË FUSHË
KOSOVË, KUVENDI KOMUNAL FUSH KOSOVË



QESHOR ,2021

Kompania „DP & PARTNERS ” Sh.p.k., Prishtinë, për kryerjen e Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Bazën për prodhimin e betonit., zona kadastrale Fushë Kosovë , KK Fushë Kosovë, autorizon Kompaninë N.SH. “ING-CONSULT”nga Lipjani:

Investitori: Fushë Kosovë shpk

Durim Prishtina _____

Hartuar nga kompania N.SH. “ING-CONSULT” LIPJAN

Hartuar nga persona të Licencuar:

1. Sami Heta



2. Ejup Retkoceri



3. Luljeta Ajdini



N.SH." ING-CONSULT"



Përmbajtja

faqe

1. Hyrja	5
2. Baza ligjore për hartimin e Raportit.....	6
2.1.. Rregullativa ligjore	6
2.2. Metodologjia e punës.....	7
3. Përshkrimi i Lokacionit dhe Mjedisit	8
3.1. Pozita gjeografike e lokacionit.....	8
3.2. Popullata dhe Vendbanimet.....	11
3.3. Lidhjet e Komunikacionit	12
3.4. Kushtet klimatike.....	12
3.5. Erërat	13
3.6. Relievi	13
3.7. Hidrogjeologjia.....	13
3.8. Ndërtimi gjeologji i lokacionit.....	14
3.9. Natyra dhe biodiversiteti	14
3.10. Bimësia dhe vegjetacioni.....	14
3.11. Bota shtazore –Fauna.....	14
3.12. Peizazhi	15
3.13. Ajri	15
3.14. Uji.....	15
4.0 Procesi teknologjik i prodhimit të betonit	16
4.1. Objektet dhe pajimet prodhuese	16
4.2. Koncepti prodhues.....	18
4.3. Prodhimet e betonit.....	19
4.4. Komponentët në procesin e prodhimit të betonit.....	19
4.5. Përshkrimi i procesit teknologjik.....	22
5.0. Identifikimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme në mjedis	25
5.1. Ndikimet në ajër.....	25
5.2. Ndikimet në tokë	26
5.3. Ndikimet në ujë.....	26

5.4. Ndikimet në peizazh.....	27
5.5. Ndikimet në florë dhe faunë.....	27
5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë	27
5.7. Ndikime nga zhurma	28
5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore.....	28
6.0. Masat e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimeve.....	29
6.1. Masat e marura për mbrojtjen e ajrit	29
6.2. Masat e marura për mbrojtjen e tokës	30
6.3. Masat e marura për mbrojtjen e ujit	31
Skema teknologjike e trajtimit të ujërave.....	32
6.4. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma	32
6.5. Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale.....	33
7.0. Programi i monitorimit	33
8.0. Raportimi	33
9.0. Masat rehabilituese pas përfundimit të aktiviteteve prodhuese	34
10. Konkluzion.....	36

1. Hyrje

Në kuadër të aktiviteteve për marrjen e Pëlqimit Mjedisor për Bazën e betonit për prodhimin e betonit në Fushë Kosovë komuna e Fushë Kosovës kompania „DP & PARTNERS” Sh.p.k., nga Prishtina, z. Durim Prishtina, drejtor i kompanisë në programin inventiv ka paraparë, hartimin e Raportit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis të Bazës për prodhimin e betonit në Fushë Kosovë komuna e Fushë Kosovës. Raporti i VNM-së paraqet një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e pëlqimit Komunal si dhe pëlqimit mjedisor.

Raporti i VNM-s hartohet me qëllim që të identifikohen dhe analizohen ndikimet në mjedis të tërë veprimtarisë së bazës së betonit për prodhimin e betonit duke i parashtruar dhe ndërmarr masat e domosdoshme për mbrojtjen e mjedisit në lokacionin ku ushtrohet kjo veprimtari.

Në raportin e VNM-s duhet analizuar karakteristikat e gjendjes ekzistuese të mjedisit në lokalitetin e betonierës dhe prodhimin e produkteve tjera nga betoni si dhe karakteristikat e potencialeve përkatëse, nga njëra anë, dhe karakteristikat inxhinjeroko- teknike të punëve të cilat zhvillohen në bazë të projektit, nga ana tjetër, shtrohet nevoja për hartimin e Raportit ku do të përkufizohen të gjitha ndikimet relevante që mund të paraqiten në relacionin bazë e betonit për prodhimin e betonit dhe mjedisi, duke mos anashkaluar edhe ndikimet kumulative në regjionin më të gjerë.

Duke u nisur nga qëllimi paraprak dhe në metodologjinë e hartimit të vlerësimin të ndikimit në mjedis, ky Raport bëhet me qëllim të përkufizimit të ndikimeve potenciale dhe caktimin e masave të cilat do të jenë të nevojshme për tu marr për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative.

Me rastin e hartimit të Raportit janë marrë për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve gjatë realizimit të procesit teknologjik të prodhimit të betonit dhe pas përfundimit të aktiviteteve në bazën e betonit për prodhimin e betonit, kurse për fazën e ndërtimit nuk janë marr për bazë ndikimet në mjedis dhe aplikimi i masave për zvogëlimin e ndikimeve, sepse në kohën kur është hartuar ky raport ka qen e përfunduar faza e ndërtimit të bazës së betonit

për prodhimin e betonit në lokalitetin Fushë Kosovë, komuna e Fushë Kosovës

2. Baza Ligjore për Hartimin e Raportit

Raporti i VNM-së përfshin identifikimin dhe propozimin e masave mbrojtëse për mjedisin me rastin e ndonjë aksidenti ambiental gjatë funksionimit kontinuel të bazës së betonit për prodhimin e betonit edhe atë :

- Identifikimin e burimit që rrezikon mjedisin
- vlerësimin e ndikimit në mjedis
- propozimin e masave themelore për minimizimin apo zvogëlimin gjer në kufijtë e lejuar.

2.1. Rregullativa ligjore

a) Dokumentacioni normativ

Ne lidhje me vlerësimin e ndikimit ne mjedis – VNM është aprovuar Ligji për VNM (Nr. 03/L-214) i cili përcakton te gjitha procedurat për përgatitjen dhe paraqitjen për miratim te VNM. Ligji për VNM (Nr. 03/L-214) ka për qëllim për te siguruar mundësimin e një vlerësimi te përgjithshëm me ndërthurje te ndikimeve mjedisore te projekteve apo veprimtarive qe do te realizohen me qëllim qe te parandalojnë dhe te zvogëlojnë apo mënjanojnë efektet negative ne mjedis ne kohen e duhur. Ligjet dhe aktet nënligjore me te rëndësishme te aplikuara për hartimin e VNM-së për projektin e bazës së betonit për prodhimin e betonit, janë si me poshtë:

- Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025
- Ligji për VNM Nr. 03/L-214
- Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174
- Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110
- Ligji për tokën bujqësore Nr. 02/L- 26
- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja Nr. 03/L-160
- Ligji për ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147
- Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060
- Ligji për Kimikate Nr. 04/L-197

- Ligji për mbrojtjen e natyrës 03/L-233
- Ligji për mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri Nr. 04/L-012
- Udhëzimi Administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat , parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin uJOR .

b) dokumentacioni teknik

Gjatë hartimit të raportit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përpos eksperiencës profesionale ne udhëheqjen e procesit teknologjik për prodhimin e betonit dhe konsultimeve që janë bërë me ekspertët që udhëheqin procesin teknologjik, janë shfrytëzuar:

- Projekti i ndërtimit të bazës së betonit për prodhimin e betonit.
- Projekti teknologjik i bazës së betonit për prodhimin e betonit
- Projekti i maqineris të bazës së betonit për prodhimin e betonit
- Çertifikata e biznesit
- Çertifikata mbi të drejtat e pronës së paluajtshme
- Plani i situacionit
- Kopja e planit të ngastrave

Krahas parashikimeve themelore nga regullativat ligjore të cekura më lartë për nevoja të hartimit të raportit të VNM-së janë shfrytëzuar edhe regullativa tjera ligjore, duke përfshirë ligjet aplikative të cilat tani janë në fuqi.

Duke marrë parasysh faktin se një pjesë e madhe e specifikave mjedisore nuk janë përfshirë në kuadër të rregullativës së sipërshtuar për nevojat e hartimit të këtij raporti është shfrytëzuar edhe rregullativa relevante ndërkombëtare si dhe direktivat përkatëse për mjedis si që është direktiva e VNM-s (85/337/EEC)

2.2. Metodologjia e punës

Metodologjia e punës me të cilat bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis për bazën e betonit për prodhimin e betonit bëhet në disa faza edhe atë:

- a) Informatat themelore që nënkupton identifikimet si që janë :
 - burimet themelore të ndikimeve në mjedis.

- popullata ekzistuese me karakteristikat demografike.
- karakteristikat e dheut , topografia dhe peizazhi në lokacionin ku është ndërtuar baza e betonit për prodhimin e betonit
- klima e lokacionit me të dhënat meteorologjike.
- kualiteti i ajrit dhe ujit në lokacionin më të gjerë.
- bota bimore dhe shtazore në terrenin e analizuar.

b) Vlerësimi i ndikimeve sipas këtyre kualifikimeve

- madhësia dhe lloji i ndotjes
- karakteristikat dhe dominimi i materialit ndotës
- gjendja e mjedisit në terrenin e analizuar
- vlerësimi i shpërndarjes në hapësirë i materies ndotëse

c)Përcaktimi i masave mbrojtëse sipas rezultateve të arritura mbi vlerësimin e ndikimit në mjedis në lokacionin ku është ndërtuar baza e betonit për prodhimin e betonit.

Pjesa më e rëndësishme e analizës së këtij raporti i kushtohet kvantifikimit dhe vlerësimin të gjendjes ekzistuese.

Hulumtimi karakterizohet me faktin se kemi të bëjmë me vendin që ka të bëjë me potencial të shprehur ekologjik . Rezultati i këtyre analizave paraqet një dëshmi mbi gjendjen aktuale të mjedisit në këtë lokacion.

3. Përshkrimi i Lokacionit dhe Mjedisit

Karakteristikat themelore të gjendjes ekzistuese të lokacionit janë bazë themelore për hartimin e Raportit. Hulumtimi dhe vlerësimi i gjendjes ekzistuese është bërë duke i shfrytëzuar hulumtimet studimore të bëra në këtë teren .

Për të u definuar gjendja ekzistuese në mënyrë të kënaqshme dhe për të u krijuar një bazë reale për hulumtim të ndikimeve të mundshme, në kuadër të gjendjes ekzistuese janë prezantuar edhe të dhënat relevante që kanë të bëjnë me të dhënat ekzistuese morfologjike, gjeologjike, hidrologjike, hidrografike dhe meteorologjike.

3.1. Pozita gjeografike e lokacionit

Lokacioni ku do të ndërtohet baza e betonit ndodhet në Fushë Kosovë, komuna e Fushë Kosovës, gjendet në anën e majtë të rrugës Hajrullah Zymi, më saktësisht afër rrugës hekurudhore Fushë Kosovë-Prishtinë në drejtim Prishtinës.



Fushë Kosova është qytezë dhe komunë në pjesën qendrore të Kosovës. Komuna i takon Regjionit të Prishtinës, ajo është formuar në vitin 1989 nga një pjesë e Komunës së atëhershme të Prishtinës. Sot është një nga komunat më dinamike e cila po përjeton ndryshime të mëdha urbanistike. Qyteti ndodhet në jug-perëndim të qendrës së Prishtinës. Demografia e kësaj komune ka ndryshuar në dekadat e fundit.


Baza e Betonit është e vendosur në ngastrën kadastrale Nr.P-72514036-00134 -2 numri i lëndës: 14-942-16717, Zona Kadastrale Fushë Kosovë , komuna e Fushë Kosovës me sipërfaqe të përgjithshme 18645 [m²] , ngastrat kadastrale e lartcekur është pasuri e Durim Prishtinës e që njëherit është pronar i kompanisë “ DP & Partners “ sh.p.k .

Baza e betonit kufizohet nga ana e majtë me tokë pune-arë , prapa ndodhet tokë pune-arë , shtëpia nuk ka, djathtas ndodhet kompania Tregtija, para bazës së betonit gjendet rruga dhe pas rrugës është Hekurudha dhe pas sajë po ashtu tokë pune.Sipërfaqja ku është e ndërtuar baza e betonit është një hapësirë me sipërfaqe të rrafshet, më herët kjo sipërfaqe ka qenë e mbjellurë me të lashta bujqësore periodike, por në vitet e fundit për arsye të pozitës gjeografike , kjo sipërfaqe kanë qenë djerrinë dhe për arsye se rrethina e lokacionit është duke u shndërruar në zonë industriale. Lokacioni për rreth ngastrës ku është e ndërtuar baza e prodhimit të betonit çdo ditë është duke u shndërruar në zonë industriale për shkak të pozitës gjeografike që ndodhet lokacioni, për arsye se afër lokacionit në distancë 3 km kalon Autostrada Prishtinë- Fushë Kosovë – Prizren , si dhe lidhja e autostradës me të gjithë Kosovën, përgjatë rrugës transite janë ndërtuar dhe janë duke u ndërtuar objekte afariste.

Në bazë të gjitha analizave është sajuar mundësia për vlerësimin global të gjendjes ekzistuese të mjedisit jetësor si dhe ndikimeve të mundshme negative gjatë punës së bazës për prodhimin e betonit.

Këto vlerësime shërbejnë si bazë për kuantifikimin e ndikimeve të mundshme dhe për përcaktimin e masave të nevojshme mbrojtëse duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një projekt që mund të ketë ndikime të theksuara në mjedis. Lokacioni ku është e ndërtuar Baza e betonit shihet në hartat topografike të mëposhtme.





3.2. Popullata dhe Vendbanimet

Njërën nga veçoritë qenësore të hapësirës së analizuar, në kuptim të përcaktimit të ndikimeve të mundshme në mjedis, paraqet popullata dhe demografia e sajë. Këto fakte kuptimin e plotë të tyre e kanë në hulumtimin e hollësishëm të ndikimeve të mundshme negative në banorë që jetojnë në hapësirën e analizuar. Lokacioni për rreth ngastrës ku është e ndërtuar Betoniera ndodhet ne lagje te pa banuar, nuk do të ketë ndonjë ndikim relevant në popullatë, përpos që do të kenë vetëm dobi sepse një pjesë e komunitetit janë të punësuar në kompaninë „DP & Partners ” për kryerjen e aktiviteteve në këtë qendër ku prodhohen lloje të ndryshëm te betonit..

3.3. Lidhjet e Komunikacionit

Sa i përket infrastrukturës ekzistuese, infrastruktura rrugore është e ndërtuar, në afërsi të lokacionit ku është kompania “ DP & Partners “ kalon rruga lokale

Hajrullah Zymi e cila e lidhë me rrugët tjera të Fushë Kosovës e pastaj me Prishtinën dhe përmes autostradës Prishtinë – Fushë Kosovë - Prizren me gjithë Kosovën, lokacionin ku është e vendosur betoniera, me të gjithë rrjetin rrugor të Kosovës, furnizimi me energji elektrike e qendrës bëhet përmes trafos pronë private e pronarit të kompanisë , gjithashtu ne këtë lokacion është i ndërtuar sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit.

3.4. Kushtet klimatike

Klima e kësaj treve sipas pozitës së saj gjeografike, lartësisë mbi detare dhe sipas hulumtimeve meteorologjike siç janë: reshjet dhe temperaturat mesatare mujore dhe vjetore, është klimë kontinentale. Sa i përket reshjeve dhe temperaturave, Pranvera dhe Vjeshta karakterizohen për afërsisht me klimë të njëjtë. Të reshurat janë të formës riguese ose me karakter lokal. Temperatura mesatare sillet prej 11,5°C gjer në 12,5°C e si mesatare e këtyre merret temperatura prej 12,0°C.

Temperaturat më të larta janë në muajin qershor 35,6°C, ndërsa në korrik 32,4°C dhe në gusht 31,1°C. Temperaturat më të ultë janë në muajin dhjetor, janar dhe shkurt. Temperaturat maksimale mesatare vjetore janë 22,5°C, ndërsa temperaturat mesatare minimale sillen prej -0.5°C.

Regjimi i reshjeve ne komunën e Fushë Kosovës ka karakterin e klimës aride. Shuma e përgjithshme e reshjeve sillet nga 499 mm deri ne 675 mm. Vlera mesatare vjetore e lagështirës relative është 76.8%. Muaji më i thatë është gushti 66.2%, kurse më me lagështi janë nëntori dhe dhjetori 84.2 %.

Në komunën e Fushë Kosovës erërat më të shpeshta janë ato veriore me 226‰ dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 27‰, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 2.2 m/sek.

3.5. Erërat

Në lokacionin ku është e ndërtuar baza e betonit dhe reparti për prodhimin e produkteve nga betoni më së shumti janë të përfaqësuara erërat veriore.

Me intensitet më të madh të shpejtësisë paraqiten erërat veriore, veri perëndimore si dhe erërat perëndimore, kurse ato jugore janë me intensitet më të vogël.

Në komunën e Fushë Kosovës erërat më të shpeshta janë ato veriore me 226‰ dhe më të rrallat janë ato jug – perëndimore me 27‰, kurse shpejtësia mesatare më e madhe e erës është 1.2 m/sek.

3.6. Relievi

Rajoni ku është e ndërtuar baza e betonit për prodhimin e betonit karakterizohet me relief të rrafshët, kurse rajoni i gjer karakterizohet me një relief fushor kurse rajoni më gjer kodrinoro -malor.

Relievi me larësit, pjerrtësitë dhe ultësirat e ndryshme ndikon në formimin dhe ndërtimin e elementeve klimatike, në shfaqjen e të reshurave klimatike dhe formimin e rrjetit ujor të cilat drenohen në proçkat për rreth.

3.7. Hidrogjeologjia

Në afërsi të kompanisë “AS Partners” burime natyrore të ujit nuk ekzistojnë, ujërat sipërfaqësore paraqiten vetëm gjatë të reshurave atmosferike, të cilat përmes pjerrtësive të ndryshme dhe luginave natyrore drenohen në lumin e Graqankës i cili pastaj drenohet në lumin e Sitnicës, ku kompania gjendet e larguar nga lumi i Graqankë mbi 4000m. Sitnica rrjedh nëpër terren fushor me një pjerrtësi mesatare 2,3 km. Sitnica është degë kryesore e Ibrit. Ky lum dallohet jo vetëm për kah madhësia e pellgut (2.861 km katrorë), por edhe me prurje vjetore (16, 6 m³ në sec.) Sitnica formohet nga rrjedha Matica me Sazlinë dhe lumin e Shtimes. Këto rrjedha afër fshatit Robovc bashkohen, duke formuar lumin Sitnicë, nga këtu e deri në vëndderdhje në lumin Ibër, afër Mitrovicës kalon gjatësinë prej 90 km. Veçori e këtij lumi është pjerrtësia e vogël, pra karakterizohet si lum fushor.

3.8. Ndërtimi gjeologjik lokacionit

Me qenë se baza e betonit për prodhimin e betonit janë të ndërtuara, atëherë nuk do të bëhen aso hulumtime gjeomekanike të cilat do të ishin përdorur për përgatitjen e llogarive statike të fundimit (themelit) të bazës së betonit për prodhimin e betonit.

3.9. Natyra dhe biodiversiteti

Në bazë të dhënave zyrtare të Institutit për mbrojtjen e Natyrës , nuk ekzistojnë të dhëna se në këtë teren kemi të bëjmë me ndonjë hapësirë të mbrojtur me ligj, në drejtim të biodiversitetit dhe natyrës në përgjithësi, por as që është ndonjë zonë/teritor që është potencial të futet nën mbrojtje .

3.10. Bimësia dhe vegjetacioni

Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve bimore nuk është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjell përfundime meritore.

Mirëpo në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethin të zonës ku është ndërtuar baza e betonit për prodhimin e betonit kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, kulturat bujqësore periodike, kurse në lokacionin më të gjer bimësi drusore si qarri, bungu, kaça, murrizi, mana, manaferra, kurse ngastrat ku është e ndërtuar baza e betonit për prodhimin e betonit më herët kanë qenë të mbjell ura me të lashta periodike bujqësore e pastaj djerrin.

3.11. Bota shtazore – fauna

Ndikimi i bazës së betonit për prodhimin e betonit., në domenin e florës dhe faunës paraqet dukuri që kërkon shqyrtim të kujdesshëm, në kuptim të evidencimit të pasojave të ndryshme të mundshme negative dhe zvogëlimit të tyre brenda kufijve të pranueshëm.

Ajo që dallon florën dhe faunën e këtij regjioni janë ndryshimet intensive si pasojë e veprimtarisë së njeriut. Problematika e gjendjes ekzistuese të llojeve bimore nuk

është studiuar në masë të mjaftueshme për të sjellë përfundime meritore. Në ngastrat ku është ndërtuar të baza e betonit për prodhimin e betonit., kanë qenë ara me të mbjellura me kultura bujqësore sezonale duke pasur parasysh hapsirën ku është ndërtuar qendra e grumbullimit dhe çmontimit të automjeteve mbeturinë dhe komponentët e tyre, tani nuk ekziston bimësi e mbjellur si kultura bujqësore sezonale, mirëpo në bazë të shqyrtimeve vizuale në rrethin të zonës më të largët ku realizohet projekti kemi hasur në bimësi që karakterizohet kryesisht nga bimët e ulta barishtore, kultura periodike bujqësore si dhe të gjitha pemët frutore të grupit faror dhe atyre bërthamore. Pyjet e këtij regjioni kryesisht janë pyje të llojit gjethor dhe përbëjnë një numër të madh të llojeve, si që janë bingu ,qarri ,ahu si dhe bredhi i kultivuar etj. me rritje të ulta dhe mesatare.

Bazuar në florën ekzistuese dhe kushtet klimatike të rajonit të Fushë Kosovës e duke marrë për bazë edhe të dhënat nga vendasit, përpos kafshëve dhe shpezëve shtëpiake që i posedojnë fshatarët, në rrethin të kësaj zone, jetojnë gjitarët , zvarranikët , brejtësit , insektet e ndryshme, lepuri i egër, dhelpra, ujku, iriqi, etj. Ndërsa prej shpezëve janë karakteristike: bilbilat, thëllëza e fushës, serrat, shqiponja, etj.

3.12. Peizazhi

Karakteristikat e peizazhit të tërësisë së analizuar hapësinore paraqesin njërin nga elementet për të perceptuar marrëdhëniet e tërësishme në relacionin baza e betonit- mjedisi. Me këtë rast gjithsesi duhet marrë parasysh se bëhet fjalë për një kategori psikologjike afektive e cila manifestohet përmes veprimit të tërësishëm sinërgjik të rrethinës në shikuesin, ku medoemos janë të pranishme implikimet kulturologjike, sociologjike dhe subjektive . Efektet vizuale (peizazhet) janë kriteriume me rëndësi në ruajtjen e mjedisit dhe nëse nuk zgjidhen drejt konsiderohen si degradim i mjedisit.

Qendra e grumbullimit dhe çmontimit të automjeteve mbeturinë dhe komponentët e tyre është ndërtuar në lokacionin ku ekzistojnë objekte afariste që do të thotë se ekzistojnë objekte të ndërtuara të më hershme dhe në efektet vizuale nuk do të ketë ndikime negative se është mësuar shikuesi me këtë gjendje të mjedisit.

3.13 Ajri

Në lokacionin në fjalë deri tani nuk janë bërë matje mbi shkallën e ndotjes së ajrit, ujit, tokës dhe zhurmës në mënyrë që të bëhet një vlerësim sa më preciz i gjendjes mjedisore për lokacionin ku është e ndërtuar baza e betonit.

Nga vet pozita e lokacionit si dhe objekteve industriale ekzistuese të më hershme në rrethin dhe objektet industriale që janë ndërtuar dhe duke u ndërtuar në këtë lokacion ndikojnë në ndotjen e ajrit, frekvenca e madhe e automjeteve në rrugë lokale dhe magjistrale, gjegjësisht autostrada Prishtinë – Fushë Kosovë - Prizren ndikojnë në ndotjen e ajrit, në ndotjen e ajrit ndikojnë objektet industriale ekzistuese të më hershme si që janë KEK-u, dhe deponit e hirit, mund të konkludojmë se ndotja e ajrit në këtë regjion është e konsiderueshme.

3.14. Uji

Ndotja e ujit shkaktohet nga trafiku rrugor dhe hekurudhor i cili zhvillohet në këtë lokacion, dhe nga shpërlërja e trasës së rrugës me të reshurat atmosferike. Ndotja e ujit shkaktohet nga repartet e KEK-ut si dhe deponit e hirit. Ndotja e ujit shkaktohet nga trafiku i cili zhvillohet në magjistrale, gjegjësisht autostrada Prishtinë – Fushë Kosovë - Prizren dhe nga shpërlarja e trasës së rrugës me të reshurat atmosferike. Ndotja e ujit pjesërisht shkaktohet edhe nga lëshimi i ujërave të zeza nga komuniteti të pa trajtuara si dhe hedhja e mbeturinave në shtratin e lumit dhe përskaaj tij.

4. Procesi Teknologjik i Bazës për Prodhimin e Betonit

4.1. Objektet dhe pajimet prodhuese

Kompania „DP & PARTNERS ” Sh.p.k. në Fushë Kosovë, Fushë Kosovë për prodhimin e llojeve të betoneve në lokacionin e lartë cekur ka të vendosura një betonier dhe pajimet që do të shënohen në vijim për prodhimin e betonit.

Baza për prodhimin e betonit përbëhet prej këtyre objekteve dhe pajisjeve:

- Objekti i administratës

- Bunkerët e agregatit: $17.5 + 17.5 + 17.5 + 17.5 = 70$ [m³] se bashku me pistonat dhe pajisjet përcjellëse,
- Transportieri horizontal mbledhës – Dozatori,
- Transportieri i pjerrët furnizues i agregatit,
- Përzierësja e betonit – Mikseri,
- Siloset e çimentos (me vëllim $V = 2 \times 75$ [ton] = 150 [ton]),
- Transportierët kërmillor nga siloset e çimentos (2 x Φ 273 X 11500 [mm]),
- Kompresori i ajrit të komprimuar ($P = 7.5$ [kW], $V = 500$ [litra]),
- Pompat e aditivit të çimentos,
- Pompa e ujit me pajisje përcjellëse,
- Rezervari nga betoni për ujë,
- Kabina komanduese e Bazës së Betonit,
- Hapësira dhe pompa për pastrimin e autocisternave,
- Euro filtrat në siloset e çimentos,
- Gjeneratori me naftë,
- Trafo elektrike 250 [kVA], 10/0.4 [kV].
- Betoniera është adekuate për prodhimin e betonit dhe i përgjigjet ISO standardeve.

Kapaciteti prodhues i Bazës së Betonit është: $Q = 180$ [m³/h].

Prodhuesi i Bazës së Betonit është: **ELKON, TURK viti i prodhimit 2021.**

Në fotot në vijim shihet baza e prodhimit të betonit me objektet përcjellëse.





4.2. Koncepti prodhues i betonierës

Kompania „DP & PARTNERS ” Sh.p.k., posedon teknologji dhe pajime me të cilat mundë të prodhoj të gjitha llojet e betonit të cilësisë së lartë. Materialet e nevojshme për prodhimin e betonit janë: çimentoja, fraksionet e gurit / rërës, uji dhe aditivët. Fraksionet e gurit/rërës janë: +0-4mm, +4-8mm, +8-16mm dhe +16-22mm ose +16-31.5 mm.

Procesi i prodhimit të betonit është proces i mbyllur, i tërë procesi kontrollohet dhe menaxhohet në mënyrë bashkëkohore.

4.3. Prodhimet e betonit

Betoni paraqet konglomerat që përfitohet me përzierjen e çimentos, fraksioneve të rërës/gurit dhe ujit. Me programin e prodhimit parashihet prodhimi i këtyre llojeve të betoneve:

- Betonet Plastike 0-16 (MB15, MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)

- Betonet Plastike 0-31.5 (MB10, MB15, MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Beton i Ajruar 0-16 (MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Beton i Ajruar 0-31.5 (MB20, MB25, MB30, MB35, MB40)
- Beton i Qëndrueshëm ndaj ujit 0-16 (MB20, MB25, MB30, MB35,)
- Beton i Qëndrueshëm ndaj ujit 0-31.5 (MB20, MB25, MB30, MB35)

Përpos këtyre llojeve të betoneve mund të prodhohen edhe lloje të veçanta të betoneve: për ndërtim të rrugëve, urave, tunele, për konstruksione nën ujë etj. Si dhe për prodhimet e të gjitha llojeve të produkteve nga betoni që janë: kubzat e të gjitha formave dhe me dimensione të ndryshme, bllokat me madhësi të ndryshme, gypat me madhësi të ndryshme, ne bazë të kërkesave të blerësve .

4.4. Komponentët në procesin e prodhimit të betonit

Çimentoja- paraqet komponentin lidhës të betonit. Sipas teknologjisë për prodhimin e betonit në betonier përdoret çimentoja Portland. Në raste të veçanta varësisht prej llojit të prodhimit të betoneve, përdoren çimentot speciale. Cilësia e çimentos përcaktohet në bazë të aftësisë lidhëse të shprehur nëpërmjet fortësisë. Dallojmë disa lloje të fortësisë: 200, 320, 500, 600 dhe 800 kp/cm². Çimentoja Portland nuk duhet të ketë aftësi në fortësi më të vogël se 320 kp/cm². Sasia për prodhimin e betonit, përkatësisht harxhimi specifik i çimentos, është 200-400 kg për 1m³

Agregati - guri /ose rëra Kompania „DP & PARTNERS ” Sh.p.k. me këtë material (fraksionet e gurit gëlqeror ose të rërës) për arsye të cilësisë së lart të dëshmuar furnizohet nga gurthyesit dhe seperacionet ne rajon.

Agregati duhet të përmbush kushtet e parapara në pikëpamje të cilësisë dhe granulimit. Rëra cilësore duhet të jetë e pastër dhe me përbërje të lartë të kuarcit. Agregati duhet të jetë pa asnjë shtesë të cilat reagojnë me ujin dhe shkaktojnë shkapërderdhje, kloridet, sulfatet dhe komponimet tjera kimike që dëmtojnë vetit fizike dhe mekanike të betonit nuk guzojnë të jenë të pranishme .

Materiet organike dhe humusi pengojnë ngurtësimin e çimentos në beton. Preferohet që raporti i agregatit ne beton të jetë 1:2- 1:7, varësisht prej llojit të betonit që kërkohet të prodhohet.

Uji- është komponent i rëndësishëm për lidhje gjatë prodhimit të betonit.

Çështjen e ujit pronari e ka të zgjidhur më anë të pusit, të cilin e ka shpuar, me anë të pompave e mbushë rezervuarin i cili nevojitet për mbajtjen e ujit rezervë për nevoja të betonierës, pusi dhe rezervuari gjinden në afërsi të betonierës dhe në pronësi të pronarit të kompanisë „DP & PARTNERS ” Sh.p.k.

Në procesin e prodhimit të betonit duhet të përdoret vetëm uji i pastër, ujë që nuk përmban materie organike që formohen nga bimët e kalbura.

Harxhimi specifik i ujit në procesin teknologjik për prodhimin e betonit varet nga lloji i betonit që dëshirojmë të prodhojmë.

Në vijim do të i pet përqindja e ujit në beton në varësi nga lloji i betonit:

- për beton të lëngshëm 6- 8%
- për beton plastik 7- 9%
- për beton të fortë plastik 8-10%

Si që kemi cekur ne pasuset e më sipërme ne këtë betonier mund të prodhojmë beton të kualiteteve të ndryshme duke u bazuar ne destinimin e tij dhe atë sipas nevojës dhe kërkesave të hargjuesve të betonit.

Në tabelën e më poshtme po e japim një shembull që paraqet sasinë e agregatit sipas fraksioneve dhe atë pa fraksionin +16-31.5mm, sasinë e çimentos dhe sasinë e ujit që nevojitet për prodhimin e 1m³ beton llojit MB-30, sipas recepturës së caktuar:

Agregati

fraksionet	+0-4mm	+4-8mm	+8-16mm	
përqindja	45%	20%	35%	
sasia	824kg	366kg	642kg	= 1832kg
Çimentoja				350kg
Uji				238kg

Nga kjo recepturë e lartshënuar mund të caktohet edhe bilanci material për prodhimin e 1m³ beton që shihet në tabelën e më poshtme;

Hyrja		Dalja	
Agregati	1832kg	1m ³ beton	2420kg
Çimentoja	350kg		
Uji	238kg		
Bilanci i përgjithshëm	2420kg		2420kg

Në tabelën në vijim po e japim një shembull për sasinë e agregatit sipas fraksioneve dhe atë me katër fraksione, sasinë e çimentos dhe sasinë e ujit që nevojitet për prodhimin e 1m³ beton llojit MB-30, sipas recepturës së caktuar:

Agregati

fraksionet	+0-4mm	+4-8mm	+8-16mm	+16-31,5 mm	
përqindja	40%	15%	35%	25%	
sasia	756kg	283kg	378kg	473kg	= 1890kg

Çimentoja 320kg

Uji 220kg

Nga kjo recepturë e lartshënuar mund të caktohet edhe bilanci material për prodhimin e 1m³ beton që shihet në tabelën e më poshtme.

Hyrja		Dalja	
Agregati	1890kg	1m ³ beton	2430kg
Çimentoja	320kg		
Uji	220kg		
Bilanci i përgjithshëm	2430kg		2430kg

4.5. Përshkrimi i procesit teknologjik

Prodhimi i betonit në betonier fillon me përgatitjen e lëndëve të para: agregatit (fraksioneve të gurit apo fraksioneve të rërës), çimentos dhe ujit.

Procesi teknologjik për prodhimin e betonit, fillon me mbushjen e siloseve me rërë apo gur me granulacione të ndryshme në varësi të markës së betonit që dëshirohet të prodhohet, siloset pranues me fraksione të gurit ose rërës mbushen

me anë të lopatës ngarkuese nga depoja e fraksioneve të agregatit, katër siloet me fraksione të gurit ose rërës, janë të ndara njëra prej tjetrës me mure të pllakave të qelikut.

Proces tjetër paraqitet mbushja e silosi me çimento të tipit të caktuar ,mbushja bëhet me anë të auto-cisternave me proces pneumatik.

Në procesin teknologjik bëjnë pjesë tërë sistemi i pajimeve të furnizimit me ujë, pompave hidraulike, pneumatikës, pajimeve elektrike dhe automatike në veçanti.

a. Agregati nga të katër siloet ku në dalje të cilëve ndodhën dozuesit elektro-pneumatik të cilët me dhënien e komandës nga tabela komanduese hapen dhe mbyllen në mënyrë automatike pasi të lëshojnë sasinë e caktuar të agregatit në shiritin transportues që ndodhet nën silosin e agregatit i cili i transporton granulacionet (fraksionet) e agregatit gjër në shiritin transportues horizontal i cili nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjër në auto-mikser (auto-përzierës) për prodhimin e betonit . Në dozuesit e fraksioneve më të imta janë të vendosur vibruesit me qëllim të rrjedhjes së fraksioneve sa më lehtë në enën e agregatit, kur të dozohet sasia e dëshiruar e agregatit, në transportier e pastaj nga transportieri shiritor në transportuesin shiritor horizontal i cili nevojitet për bartjen e fraksioneve të agregatit gjër në auto-mikser (auto-përzierës).

b. Dozimi i çimentos në përzierës bëhet nëpërmjet transportuesit kërmillor nga silosi. Çimentoja me ramje të lirë bien në transportuesin të vendosur nën silos , pasandaj nëpërmjet transportuesit kërmillor dozohet në enën e peshojës për çimento. Zbrazja e enës së peshojës kryhet në mënyrë të programuar dhe atë në kohën e dozimit të agregatit në auto-mikser (auto-përzierës). Ashtu që zbrazja e pajisjes për dozim të çimentos nëpërmjet transportuesit kërmillor (i cili është i vendosur paralel me shiritin transportues horizontal për transportimin e agregatit) në auto-mikser (auto-përzierës) fillon automatikisht në momentin e fillimit të dozimit të agregatit nga ena në auto-mikser (auto-përzierës), apo disa sekonda më vonë. Gjatë kohës së zbrazjes së enës së peshojës me çimento duhet të lëshohet vibruesi, kur procesi kryhet në mënyrë manuale, kur procesi kryhet në mënyrë automatike vibruesi lëshohet në mënyrë automatike.

c. Dozimi i ujit në përzierës si lëndë e parë bazë për përfitimin e betonit bëhet me dozimin e programuar nga pompa për furnizim me ujë kryhet gjithashtu në mënyrë

automatike me fillimin e dozimit të çimentos. Pas dozimit të sasisë së caktuar të ujit, ventili dozues automatikisht mbyllet. Nëse janë përmbushë kushtet e procesit për punë automatike (sasia e nevojshme e agregatit në fortin, shtypja e ujit duhet të jetë min. 3at. dhe sasia e nevojshme e çimentos), sasia e prodhuar e betonit për një cikël është $8m^3$, zgjatja e një cikli është përafërsisht 14 min. në varshmëri të llojit të betonit. Gjatë kryerjes së procesit në mënyrë emanuele koha e zgjatjes së ciklit varët nga aftësia e punëtorit që operon me pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.

Para se të lëshohen pajimet për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, duhet të kryhen këto veprime;

- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e agregatit në silos.
- Duhet të sigurohet sasia e mjaftueshme e çimentos dhe duhet hapur vetëm ventilin e silosit nga i cili dëshirojmë të marrim çimento.
- Duhet të sigurohet sasia e nevojshme e ujit.
- Duhet caktuar recepturën për kualitetin e betonit të cilin dëshirojmë të e prodhojmë
- Të caktohet zgjatja e kohës së ciklit të prodhimit të betonit duke u bazuar në recepturën e caktuar.

Pajimet mund të funksionojnë në mënyrë automatike me dozim të programuar dhe në mënyrë emanuele.


Menaxhimi i procesit teknologjik i prodhimit të betonit, kryhet nga pulti komandues i automatizuar i vendosur në dhomën (hapësirën) të caktuar për te.

Modulet hyrëse drejtpërdrejt pranojnë sinjalet nga dozatorët dhe peshojat, nëpërmjet sondave për të gjithë komponentët e procesit të prodhimit.

Modulet digjitale dalëse shërbejnë për menaxhimin e ventileve elektromagnetikë, motorëve si dhe llampave sinjalizuese.

Menaxhimi i tër procesit të prodhimit behet edhe përmes disa monitorëve të vendosur ne panelin e komandimit, përmes këtij paneli operatorit i mundësohet të bëj mbikëqyrjen e tër procesit dhe recepturat për prodhimin e betonit, me këte mundësohet matja lehtë e komponentëve të agregatit , çimentos dhe komponentëve tjera shtesë.

Paraqitja skematike e procesit teknologjik të bazës së betonit



Për të arritur cilësinë e duhur të betonit bëhet sitja e çimentos me sita standarde dhe përcaktohet kohëlidhja e sajë. (Kohëlidhja e çimentos paraqet kohën nga momenti i përzierjes së çimentos me ujë gjer në momentin e fillimit të hidratimit të sajë dhe arritjes së fortësisë përkatëse). Përpos komponentëve të lartcekura për të arritur veçori specifike të betonit, duhet shtuar Aditivët.

Në sezonin e dimrit dhe për konstruksione të veçanta shtohen aditivë të cilët e shpejtojnë kohën e ngurtësimit. Aditivi kryesisht shtohet me ujë , ose drejtë për drejt në mikser. Dozimi i aditivit kryesisht shtohet 2-4% të masës së çimentos.

Për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, me energji elektrike furnizohet nga rrjeti elektrik nëpërmjet trafos të ndërtuar nga kompania, gjithashtu ne mungesë të energjisë elektrike kompania posedon gjeneratorin për realizimin e procesit teknologjik.

Përpos pajisjeve të lartë cekura për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit dhe për bartjen e tij gjer te hargjuesi (konsumatori), kompania disponon edhe këtë mekanizëm: katërë auto mikserë dhe ate 4x8m³, një auto

cisternë për bartjen e çimentos, një pompë të betonit (70m³/orë), dy kamionë për bartjen e fraksioneve të agregatit dhe dy lopata ngarkuese.

Bazuar në kërkesat dhe përvojën e punës në këtë betonier, punët do të organizohen vetëm në ndërrimin e par.

Fuqia punëtore e angazhuar është e konsiderueshme dhe do të ketë ndikim pozitiv në punësimin e popullatës.

5. Identifikimi dhe Përshkrimi i Ndikimeve të Mundshme në Mjedis

5.1. Ndikimet në ajër

Në aktivitetin e prodhimit të betonit, ndikime negative paraqiten në ambientin e ajrit dhe atë:

- Nga procesi teknologjik për prodhimin e betonit nga ku lirohen grimcat e pluhurit të çimentos, dhe grimcat e pluhurit nga fraksionet e agregatit që përdoret për prodhimin e betonit, grimcat e pluhurave të cilat gravitojnë për shkak të peshës së tyre në drejtim të tokës, dhe depozitohen në afërsi të betonierës, pluhurat kanë përbërje të elementeve kimike që posedon çimentoja dhe vetë lënda minerale, pluhurat të cilat i bartë ajri për shkak të reliefit dhe kushteve tjera mjedisore gravitojnë në distanca më të largëta, kjo situatë e përshkruar, kishte me qenë pa përdorimin e masave për zvogëlimin e pluhurit.
- Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimimit të pluhurit gjatë zbrazjes së çimentos nga auto cisternat dhe mbushja e silosit me çimento, gjatë sjelljes së çimentos nga silosi në mikser, nga mundësia e lirimimit të pluhurit të çimentos drejtpërdrejt nga vendet lidhëse të gypave përcjellës (transportues) të çimentos , nga mundësia lirimimit të pluhurit nga sipërfaqet manipuluese.
- Ndotja e ajrit vjen edhe gjatë lirimimit të gazrave nga automjetet e transportit dhe automjeteve tjera të rënda që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit.

5.2. Ndikimet në tokë

Në aktivitetin e prodhimit të betonit, ndikime negative në mjedis paraqiten në tokë dhe atë:

- Ndikimet negative nga mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmave, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët.
- Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet depozitimi i pluhurit i cili krijohet nga proceset teknologjike të cekura në pasusin e sipërm (ndikimet në ajër), si dhe ngjeshjen e tokës të cilën e shkaktojnë makinat punuese.
- Ndikim tjetër me rëndësi në tokë paraqitet edhe nga deponimi i fraksioneve të agregateve si dhe depozitimi i pluhurit nga këto fraksione.
- Ndikimet nga mbeturinat e lëngëta të cilat shkaktohen nga derdhja e vajrave dhe derivateve të ndryshëm nga mjetet punuese dhe gjeneratorit gjatë furnizimit dhe ndërrimit të tyre, gjatë përcitjes të gypave hidraulik të mjeteve punuese.
- Ndikimet nga mbeturinat e ngurta dhe lëngëta që krijohen nga larja e makinave prodhuese, auto-mikserëve, dhe automjetet tjera transportuese.

5.3. Ndikimet në ujë

Ndikime negative në ujë shkaktohen:

- Nga derivatet , vajrat dhe yndyrat (lyersit) e ndryshme të cilat derdhen në tokë nga makinat prodhuese dhe tjera të cekura në pasuset e më sipërm me derdhjen e tyre në tokë ndikojnë në ndotjen e ujërave sipërfaqësore me rastin e të reshurave atmosferike si dhe ndotjen e ujërave nëntokësore.
- Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor.
- Ndikimet tjera negative janë edhe derdhja e ujërave të përdorura në procesin teknologjik për prodhimin e betonit, nga larja e makinave prodhuese, e automjeteve transportuese, auto- mikserëve që përdoren për transportimin e betonit.
- Nga derdhja e ujërave të zeza,

5.4. Ndikimi në Peizazh

Lokacioni ku është e ndërtuar baza e betonit për prodhimin e betonit me objektet përcjellëse, për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, ka marrë pamjen e vendit industrial.

Gjatë fazës së ndërtimit peizazhi ka pësuar një degradim i cili me masat të cilat janë marr pas ndërtimit të bazës së betonit dhe do të merren në mbarim të jetë gjatësisë së projektit, peizazhit do ti kthehet pamja në harmoni me gjendjen e përafërt të mjedisit rrethues. Këto masa do të arrihen me aplikimin e rikultivimit.

5.5. Ndikimi në florë dhe faunë

Për shkak të proceseve operuese që zhvillohen në Betonier për prodhimin e betonit në gjatësinë kohore të operimit dhe në sipërfaqet operuese për rreth betonierës flora tërësisht është e shkatërruar, e cila duhet të rikultivohet pas përfundimit të punëve prodhuese.

Fauna nuk do të dëmtohet fizikisht për arsye se do të largohen nga regjioni i veprimtarisë prodhuese dhe do të zhvillohet në terrenin e përafërt që i përshtatet faunës. Gjatë kohës kur pushon aktiviteti prodhues fauna prapë kthehet për të u zhvilluar ne hapësirat e mëparshme.

5.6. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë

Nga zhvillimi i aktivitetit prodhues në këtë lokalitet për shkak të pozitës dhe largësisë nga vendbanimet si që e kemi cekur në pasuset e më parme, nuk do të ketë nevojë të bëhet ç'vendosja e asnjë ndërtese banuese e as ndërtesave tjera ndihmëse. Zhvillimi i veprimtarisë prodhuese në këtë lokalitet, ka një rëndësi të veçantë për popullatën e këtij rejoni.

Pronari i kompanisë „DP & PARTNERS ” Sh.p.k., për të zhvilluar veprimtarin e vet ne bazën e betonit ne Fushë Kosovë KK Fushë Kosovë ka të punësuar një numër të konsideruar të punëtorëve, kryesisht nga popullata vendase. Prandaj si u cek më lartë në aspektin social do të ketë ndikime pozitive.

5.7. Ndikimet nga Zhurma

Zhurma, si element në teknologjinë e prodhimit të betonit ka një karakter lokal dhe pa ndikim në zonat e banuara. Zhurma vjen si rezultat i aktivitetit të pajimeve për realizimin e procesit teknologjik, nga makinat gjatë procesit të transportit, mirëpo për shkak të pajimeve teknologjike dhe atyre transportuese që mirëmbahen dhe funksionaliteti i tyre kontrollohet rregullisht, niveli i zhurmës është nën kufijtë e lejuar me standarde.

Me shfrytëzimin e pajimeve prodhuese në bazë të standardeve të caktuara me ligje dhe rregulla të aplikueshme maksimumi i zhurmës në burim është 80 dB.

Niveli i zhurmës për zonat e banuara në bazë të standardeve ndërkombëtare është i caktuar 50 dB për kohën gjatë ditës, kurse gjatë natës niveli i zhurmës duhet të jetë max. 45 dB. Në vijim po e paraqesim në formë tabelore nivelin e zhurmës në varshmëri nga distanca.

Zhurma	Distanca (m)			
	10	50	100	500
90db –niveli Për pajisje moderne	59	45	39	25

Në bazë të vlerave të paraqitura në tabelë dhe duke pasur parasysh distancën e ndërtesave të banimit si dhe kapacitetin e pajimeve dhe numrin e mjeteve transportuese që nevojiten për realizimin e procesit teknologjik për prodhimin e betonit, si dhe duke pasur parasysh se punohet vetëm ditën, mund të konkludojmë se baza e betonit për prodhimin e betonit nuk do të ketë ndikime negative të mëdha në njerëzit që banojnë dhe veprojnë në rrethin të betonierës .

5.8. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore

Pasi që aktiviteti i betonierës, për prodhimin e betonit dhe pajimet tjera përcjellëse janë mire të projektuara, të vendosura dhe të monitoruara nga ekspertët e lamive përkatëse dhe një herit kur dihet se brenda veprimtarisë prodhuese nuk kemi të bëjmë me materie të rrezikshme për mjedisin, aksidente mjedisore të mëdha nuk mund të ndodhin.

Aksidentet të cilat mund të ndodhin, mund të jenë të natyrës së ndryshme dhe mund të ndodhin në çdo kohë gjatë realizimit të procesit teknologjik si:

- Nga rrjedhjet e ndryshme të lëndëve djegëse dhe lubrifikuese.
- Nga mekanizmi punues (mundësia e ndezjes).
- Nga mekanizmi punues mundësia e përcitjes së gypave hidraulik.
- Nga aksidentet e mundshme ne komunikacion gjatë transportit të agregatit, çimentosdhe betonit.
- Nga aksidentet e mundshme ne komunikacion gjatë kyçjes së automjeteve transportuese nga baza e betonit ne rrugën tranzite.

6. Marrja e Masave për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Ndikimeve

6.1. Masat e marura për mbrojtjen e ajrit

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ajër të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa:

- Pluhuri i cili lirohet gjatë procesit teknologjik të prodhimit të betonit duhet të mënjanohet apo zvogëlohet gjerë në kufijtë e lejuar, që nuk do të ketë ndikime të mëdha për mjedisin.
- Për mënjanimin dhe zvogëlimin e sasisë së pluhurit kompania ka të instaluar sistemin e filtrave me thasë në siloset që përdoren për deponimin e çimentos.
- Të gjithë gypat që nevojiten për mbushjen e siloseve me çimento, si dhe gypat të cilët e furnizojnë mikserin- përzierësin me çimento duhet rregullisht të kontrollohen, pjesët lidhëse të tyre të mbyllen hermetikisht me mbyllje adekuate.
- Thasët e filtrave të kontrollohen rregullisht dhe nëse dëmtohen të ndërrohen.
- Duhet të behët kontrollimi i rregullt teknik i automjeteve transportuese që konsumojnë lëndë të lëngëta djegëse me qëllim që lirimi i gazrave nga automjetet e lartë cekura të jetë sa më kualitativ.
- Gjithmonë duhet të bëhet spërkatja me ujë e sipërfaqeve operacionale, larja e platos ku janë të vendosura pajimet për prodhimin e betonit, granulacionet e agregatit sidomos gjatë kohës me erëra dhe temperatura të larta të spërkatën me ujë.

6.2. Masat e marura për mbrojtjen e tokës

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në tokë të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmarr këto masa:

- Duhet në mënyrë të rregullt të mirëmbahen stabilimentet që nevojiten për realizimin e procesit për prodhimin e betonit, të mirëmbahen filtrat në siloset e çimentos, të mirëmbahen gypat të cilët përdoren për përcjelljen e çimentos prej auto-cisternave gjer në silos dhe prej silosit gjer në pajimet për prodhimin e betonit, të gjitha pjesët lidhëse të gypave të puthiten mirë me qëllim të pengimit të lirim të pluhurit.
- Duhet të merren masat e nevojshme për mos lëshuarjen e pa kontrolluar të derivateve vajrave dhe lubrifikuesve nga makinat dhe pajimet prodhuese.
- Të bëhet betonimi i platos ku janë të vendosura pajimet për prodhimin e betonit dhe sipërfaqet tjera operationale.
- Tëra sipërfaqet ku janë të vendosur gjeneratori, deponimi i vajrave dhe lubrifikanteve duhet të mbulohen me beton.
- Furnizimi me ujë të pijshëm dhe për nevoja tjera që shfrytëzohet për larjen e platos manipuluese, për ujitje të sipërfaqeve gjelbëruese, bëhet nga pusi i thellë që është hapur nga pronari .
- Vaji i makinave të ndërrohet në vende të caktuara të betonuara dhe të izoluara për mos depërtimin e tyre në tokë.
- Të bëhet betonimi i platos ku deponohen mjetet themelore dhe sekondare që nevojiten për punët në ndërtimtari te ultë dhe lartë.
- Të gjitha mbeturinat e ngurta të cilat krijohen në lokacionin e betonierës duhet të grumbullohen dhe klasifikohen sipas përbërjes dhe llojit të tyre, ato metalike të deponohen në vende të posaçme, ato të cilat nuk përdoren për nevoja të kompanisë ti shiten kompanive të licencuara.
- Mbeturinat e ngurta komunale të grumbullohen dhe vendosen në kontejner të posaçëm të pajisur me kapak për mbulim, me transport vetanak apo nëpërmjet ndërmarrjeve për menaxhimin e mbeturinave, këto mbeturina të dërgohen në deponin regjionale.

- Vajrat motorike dhe ato të mirëmbajtjes së pajimeve të betonierës duhet të deponohen në enë të posaçme , dhe të u dorëzohen ndërmarrjeve të licencuara për grumbullimin e vajrave të përdorura.
- Të bëhet betonimi apo asfaltimi i pjesës së rrugës që lidhë betonierën me rrugën tranzite.
- Sipërfaqet jo funksionale të mbjellën me bimë gjelbëruese , si dhe të mbillen drunj dekorativ gjeth mbajtës.


6.3. Masat e marura për mbrojtjen e ujit

Për të parandaluar e zvogëluar sasinë e ndikimeve negative në ujë të cilat i kemi cek më lart duhet ndërmerren këto masa:

Në lokalitetin e betonierës duhet të bëhet sistemi për grumbullimin dhe bartjen e ujërave të ndotura të krijuara nga procesi i prodhimit, nga larja e automjeteve transportuese, auto-mikserëve për transportimin e betonit dhe automjeteve tjera të rënda, ujërave nga të reshurat atmosferike. Duhet rregulluar sistemin gypor për bartjen e ujërave të ndotura të cilat duhet të dërgohen për trajtim në puse sedimentuese për pastrimin e ujërave të ndotur me grimca të ngurta.

Kolektorët duhet të rregullohen në pozicionet e caktuara me qëllim që e tërë sasia e ujërave industriale dhe e të reshurave atmosferike nga platot dhe nga tëra sipërfaqet funksionale të grumbullohen dhe të orientohen në pusët sedimentuese e pastaj në seperator. Duhet të ndërtohen tre puse sedimentuese në at mënyrë që të mundë të sedimentohen grimcat e ngurta, e pas trajtimit të ujërave në pusët sedimentuse, uji të orientohet për trajtim të mëtutjeshëm në seperatorin për pastrimin e ujërave të ndotur nga derivatet dhe vajrat të cilat kanë rrjedh në sipërfaqet operacionale, nga pajimet e punës, e pasandaj ujërat e trajtuara nga seperatori të lirohen në recipient. Seperatorin duhet të rregullohet në at mënyrë që të mundë të kontrollohet rregullisht uji i cili pastrohet dhe të merren mostrat e ujit i cili pastrohet. Duhet rregullisht të pastrohen pusët sedimentuese dhe seperatori mbeturinat të cilat nxjerrën nga seperatori pas pastrimit të tij duhet të dërgohen ne deponin regjionale, mbeturinat të cilat nxjerrën nga pusët sedimentuse gjithashtu duhet të dërgohen ne deponin regjionale.

Shema teknologjike e trajtimit të ujrave



Ujërat e zeza duhet së pari te trajtohen në gropën septike e cila duhet të ndërtohet ne varshmëri me numrin e punëtorëve, dhe pas trajtimit të lëshohen ne recipient të pastërta. Gropa septike duhet të pastrohet nga kompanitë e licencuara. Rekomandohet që të ndërtohet një rezervar me qëllim të mbajtjes së ujërave të trajtuara, uji i trajtuar (pastruar) do të rikthehet në procesin teknologjik, kështu që do të mbyllet cikli i trajtimit dhe furnizimit me ujë industrial, dhe do të parandalohet shkarkimi i ujërave ne recipient. Do të ekzistojnë dy mundsi të shkarkimit të ujërave të trajtuara njëra drejt për drejt nga seperatori në recipient, tjetra mundzi prej seperatorit në rezervar, prej nga do të shkarkohet në recipient nëse nuk nevojitet për procesin teknologjik.

Ujërat nga separatorët dhe gropa septike nuk guxojnë të lëshohen në recipient apo të derdhen në natyrë pa u trajtuar nëse përmbajnë vajra dhe yndyra mbi vlerat e përcaktuara me Udhëzim administrativ Nr. 30/2014 për kushtet, mënyrat , parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor.

6.4. Masat e marura për mbrojtjen nga zhurma

Duhet të bëhen matjet e zhurmës në përputhje me ligjet dhe rregullat mbi mbrojtjen nga zhurma. Matjet duhet bërë në afërsi të objekteve të banimit. Për vlerësimin e rezultateve të fituara nga matjet duhet ti krahasojmë me vlerat e lejuara me standarde për vendet ku jetojnë dhe punojnë njerëzit.

Në raste se zhurma e mesit nga matjet tejkalon at të lejuarën atëherë duhet të merren të gjitha masat që niveli i zhurmës të bihet në nivelin e lejuar sipas rregullave në fuqi. Në varshmëri nga fazat e procesit të punës duhet edhe të punësuarit në ato vende të punës të përdorin mjetet kundër zhurmës.

6.5. Masat e marura për mbrojtjen nga rreziqet aksidenciale

Duhet të bëhet plani i intervenimit për raste të aksidenteve ekologjike.

Duhet të bëhet plani i mbrojtjevs nga zjarri. Duhet i tërë oborri i betonierës të thuret me tel gjembor. Të merren të gjitha masat për evitimin e derdhjes së derivateve të naftës dhe vajit nga makinat transportuese dhe ngarkuese si dhe pajimet tjera. Të merren të gjitha masat e sigurisë për kyçjen e automjeteve transportuese ne rrugën e asfaltuar pa penguar komunikacionin.

Të merren të gjitha masat e sigurisë konform ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mjedisit të punës.

7. Programi i monitorimit

Ndikimet direkt nga aktiviteti i betonierës, bazuar në vlerësimet e ndikimit në mjedis janë ndikimet në tokë, ajër dhe ujë. Këto ndikime janë relativisht minimale në mjedis pas marrjes së masave për zvogëlimin e këtyre ndikimeve, dhe si të tilla mund të monitorohen. Për këtë arsye nga kompania „DP & PARTNERS ” parashihet një program monitorues për të gjitha shkarkimet, ndikimet negative ne mjedis. Monitorimi i ajrit dhe ujit duhet të bëhet me marrjen e mostrave dhe kryerjen e analizave në institute adekuate dhe të raportohen në Ministri të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor sipas kërkesës së tyre.

8. Raportimi

Do të kryhet nga udhëheqja e kompanisë „DP & PARTNERS ”shpk, gjegjësisht nga ekspertët e kompanisë së paku në fund të çdo viti kalendarik, ku do ti

paraqiten të dhënat relevante nga të gjitha monitorimet e bëra brenda vitit, të cilat do të raportohen autoriteteve përkatëse, Ministrisë së Mjedisit dhe planifikimit Hapësinor sipas kërkesës së tyre dhe komunitetit lokal brenda komunës.

9.0. Masat Rehabilituese pas Përfundimit të Aktivitetit Prodhues

Pas përfundimit të jetë gjatësisë së betonierës kjo varet nga vjetërsia e pajimeve dhe nga pronari se a do të vazhdoj me këtë projekt me blerjen e pajimeve të reja apo do të e përfundoj aktivitetin e prodhimit të betonit. Pas afatit të përfundimit të aktivitetit prodhues, pajimet e betonierës duhet të çmontohen dhe të dislokohen nga ky lokalitet. Bazamentet si dhe platot nga betoni duhet të shkatërrohen, imtësohen dhe të dërgohen në deponin regjionale. Nga proceset teknologjike të prodhimit të betonit do të krijohen substrate që i takojnë kategorisë së tokave të dëmtuara d.m.th. substrate të pa përshtatshme (sterile) për rikultivim. Substrate me përmbamës të gurit gëlqeror, rërës, zhavorri dhe betoni, etj. që pa tjetër duhet të largohen dhe bëhet zëvendësimi, me një shtresë të humusit prej 0,5m trashësi të analizuar nga aspekti agrokimik, pastaj duhet të bëhet ngjeshja e e kësaj shtrese të humusit (dheut) me qëllim që të jetë shtresa ma kompakte. ashtu qe të krijohet një substrat produktiv i përshtatshëm për rikultivim. Rikultivimi i këtyre sipërfaqeve të dëmtuara përfshin rivitalizimin në tërësi të hapësirave të dëmtuara nga realizimi i projektit. Zgjedhja e modelit të rikultivimit varet nga: Qëllimi i rekultivimit i cili nënkupton që pas përfundimit të punëve në procesin teknologjik, sipërfaqeve të degraduara, prapë tu kthehet funksioni i saj primar (prodhimi i biomasës), dhe kështu të zvogëlohet ndikimi negativ i këtij projekti në ekosistem. Planifikimi i shfrytëzimit të pjesëve të ngastrës, planifikohet që pjesa e ngastrës në lokacionin ku ka qenë e ndërtuar e baza e betonit varsisht se në bazë projektit për qka do të përdoret duhet të përgatitet për përdorimin e saj, pjesët e saj që janë të parapara për hapësira të gjelbruara , të mbjellën me barë dhe drunjë dekorativë.

10. Konkluzion

Ndikimi i bazës së betonit për prodhimin e betonit në Mjedis, është në nivelin e vlerave të standardeve të caktuara me ligjet dhe aktet nënligjore për mjedis të aplikueshme. Ndikimi në tokë, ajër dhe ujë mund të kontrollohet . Këto ndikime do të monitorohen dhe do të raportohet në fund të çdo viti kalendarik, dhe sipas kërkesës së Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë.

Pas punimit të këtij raporti , mund të konkludohet se baza e betonit për prodhimin e betonit, nuk ka potencial të rrezikimit të shëndetit të njerëzve, gjithashtu ndikimet në tokë , ujë, ajër dhe peizazh, pas identifikimit dhe zbatimit të të gjitha masave mbrojtëse të rekomanduara në këtë raport, konstatojmë se ato mund të zvogëlohen në nivel të lakmueshëm, edhe të eliminohen tërësisht në fazën e rehabilitimit të hapësirave të degraduara gjatë ndërtimit dhe realizimit të projektit. Gjithashtu baza e betonit për prodhimin e betonit do të ketë edhe ndikime pozitive socio ekonomike për arsye të punësimit të punëtorëve për realizimin e prodhimit. Mendojmë se këto të dhëna janë të mjaftueshme dhe i mundësojnë Kuvendit Komunal të Fushë Kosovës si dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë dhënien e mendimit pozitiv për Pëlqim Komunal dhe Pëlqim Mjedisor për bazën e prodhimit të betonit në Fushë Kosovë KK Fushë Kosovë, sipas kërkesës të Durim Prishtina pronar i kompanisë „DP & PARTNERS ” Sh.p.k., Fushë Kosovë, Komuna e Fushë Kosovës .